



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 422/5 prot.

Tiranë, më 7.11.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 803, datë 1.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 23.10.2023, është njoftuar vendimi nr. 803, datë 1.10.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për z. Periand Teta, ish-ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 803, datë 1.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Rrethanat e çështjes**

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, z. Periand Teta ka ushtruar detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe pikën 16, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ai u kualifikua për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni. Nga aktet në fashikull rezultojnë se subjekti ka dorëzuar pranë institucioneve kompetente Deklaratën e pasurisë, deklaratën për

kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016.

2. Me vendimin nr. 657, datë 28.4.2023, Komisioni ka vendosur: [...] *Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për z. Periand Teta.[...]*, ndër të tjera, me arsyetimin se në momentin e hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor për procesin e rivlerësimit kalimtar ai ishte pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Komisioni vlerësoi se, pas pezullimit, në datën 18.7.2016, kontrata e punës si këshilltar ligjor e z. Periand Teta duhet të konsiderohej e zgjidhur, pasi kishin ndryshuar disa nga elementet thelbësore të saj, si detyra të cilën ai nuk e ushtronte më efektivisht, si dhe paga, të cilën nuk e përfitonte më lidhur me këtë detyrë.

3. Ky vendim u ankimua nga Komisioneri Publik dhe çështja kaloi për shqyrtim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 35, datë 17.7.2024, vendosi prishjen e vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit dhe urdhërimin e këtij të fundit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar, me arsyetimin se z. Periand Teta përfshihej në rrethin e subjekteve të rivlerësimit sipas pikës 4, të nenit 179/b të Kushtetutës, e duhet t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit. Kolegji, lidhur me statusin ligjor të z. Teta, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Megjithëse nuk është më në detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor, ai duhet të rivlerësohet si ish-ndihmës/ish-këshilltar ligjor me kërkesë [...]*.

4. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni vijoi procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Periand Teta, duke ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe kryer një hetim të plotë dhe gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: *vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale*.

5. Komisioni, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ, për z. Periand Teta, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji.

6. Pas marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, më datë 1.10.2024, zhvilloi seancën dëgjimore, ku ishte i pranishëm dhe subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e ndihmësit ligjor ose ish-ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë.

7. Komisioni, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta: (a) *ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale*. Në vijim, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, ndër të tjera, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë* [...].

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**8.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**9.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

**10.** Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në momentin procedural të njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**11.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**12.** Sa më sipër, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 803, datë 1.10.2024, çmon se përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar nr. 803/2024, të Komisionit, *për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë*.

## **III. Shkaqet e ankimit**

**13.** Komisioneri Publik, në analizë të vendimit nr. 803/2024 dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi konstaton ekzistencën e mospërputhjeve mes rrethanave të rastit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të Komisionit, për sa do të trajtohet në vijim:

13.1 Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në vendimin nr. 35/2024, nën dritën e legjislacionit të zbatueshëm, ka arritur në konkluzionin se: [...] *vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 657, datë 28.4.2023, duhet të prishet dhe Komisioni të urdhërohet të kryejë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, si ish-këshilltar ligjor* [...].

13.2 Komisioneri Publik, në referencë të kuadrit ligjor të zbatueshëm në lidhje me realizimin e procesit të rivlerësimit për ish-ndihmësit/këshilltarët ligjorë, vëren se gjejnë zbatim dispozitat e mëposhtme kushtetuese dhe ligjore:

(1) Në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: [...] *Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet [...].*

(2) Në nenin 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: [...] 2. *Në rast se subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë:*

*a) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve;*

*b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve [...].*

13.3 Në analizë të arsytimit të vendimit nr. 803/1.10.2024, Komisioneri Publik konstaton se Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta: (1) *ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;* (2) *ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;* (3) *ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe në referencë të bazës ligjore, shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.*

13.4 Komisioneri Publik vlerëson se, në këto rrethana, pasi Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, në kushtet kur z. Teta i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, si *ish-këshilltar/ndihmës ligjor*, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë e Kushtetutës, dhe nuk kryen detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, pasi marrëdhëniet e tij të punës janë ndërprerë që në vitin 2017, nga ana e kësaj Gjykate, e vetmja alternativë ligjore për Komisionin, pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit nga z. Teta, mbetej zbatimi i dispozitave të nenit 58, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

13.5 Komisioneri Publik, në vijim të argumentimit të mësipërm, për sa kohë subjekti është liruar nga detyra e këshilltarit ligjor dhe nuk e ushtron efektivisht këtë detyrë që nga viti 2017, në konsideratë dhe të jurisprudencës të Kolegjit:<sup>1</sup> [...] *vlerëson se vendimet e Komisionit duhet të jenë të plota dhe të qarta, ku pjesa arsyetuese dhe pjesa urdhëruese duhet të jenë në harmoni me njëra-tjetrën, pasi pjesa urdhëruese e vendimit vjen si rrjedhë logjike e analizës që i bëhet situatës faktike të konstatuar nëpërmjet provave të marra në gjykim dhe zbatimin të bazës së duhur ligjore mbi këto fakte, pasi domosdoshmëria e arsytimit të plotë dhe të qartë të vendimeve gjyqësore, është garanci për procesin e rregullt ligjor [...].*

<sup>1</sup> Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 29/2021, prg.16.

13.6 Në përfundim, në analizë të rrethanave të faktit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni, duke aplikuar nenin 58, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen mbështetje në faktet dhe parashikimet ligjore të cituara më sipër.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**14.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

**15.** Nisur nga fakti se Kolegji i shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit, si dhe korrigjon çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar;

**16.** Referuar nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkohet që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

*- Ndryshimin e vendimit nr. 803, datë 1.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe zbatimin e dispozitave të nenit 58, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.*

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**